

V E N D I M
Nr.813, datë 28.12.1998

**PËR DHËNIE NDIHME FALAS PËR FAMILJET E DËMTUARA
NË RASTE FATKEQËSISH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.8283, datë 3.2.1998 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 1998” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.206, datë 26. 3.1998 “Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komunës Maqellarë në rrethin e Dibrës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohet fondi prej 2 725 844 lekë për likuidimin e personave sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Komuna Maqellarë për kontrollin e përdorimit të këtij fondi në destinacionin e përcaktuar në pasqyrën nr.1.
3. Komunës Reç në rrethin e Dibrës, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohet fondi prej 778 660 lekë për likuidimin e personave sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.
4. Ngarkohet Komuna Reç për kontrollin e përdorimit të këtij fondi në destinacionin e përcaktuar në pasqyrë nr.2
5. Ngarkohet Prefektura Dibër për kontrollin e zbatimit të pikave 1, 2, 3, 4 të këtij vendimi.
6. Bashkisë Krujë në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohet fondi prej 394 474 lekë për likuidimin e z. Time Xhaferri, banues në qytetin Krujë, nga të cilat 350 424 lekë për blerjen e banesës së re dhe 44 050 lekë për blerjen e pajisjeve dhe orendive.
7. Ngarkohet Bashkia Krujë për kontrollin e përdorimit të këtij fondi në destinacionin e përcaktuar në pikën 6.
8. Ngarkohet Prefektura Durrës për kontrollin e zbatimit të pikave 6, 7 të këtij vendimi.
9. Komunës Labinot Mal në rrethin e Elbasanit në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohet fondi prej 795 520 lekë për likuidimin e personave, sipas pasqyrës nr.3, bashkëlidhur.
10. Ngarkohet Komuna Labinot Mal për kontrollin e përdorimit të këtij fondi në destinacionin e përcaktuar në pasqyrën nr.3.
11. Komunës Qukës në rrethin e Librazhdit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohet fondi prej 155 733 lekë për likuidimin e z. Nezir Uzuni, banues në fshatin Stroskë të kësaj Komune, nga të cilat 111 773 lekë për riparimin dhe rikonstruksionin e ndërtesës dhe 44 000 lekë për blerjen e pajisjeve e orendive.
12. Ngarkohen Komuna Qukës për kontrollin e përdorimit të këtij fondi në destinacionin e përcaktuar në pikën 11 të këtij vendimi.
13. Ngarkohet Prefektura Elbasan për kontrollin e zbatimit të pikave 9, 10, 11, 12 të këtij vendimi.
14. Bashkisë Mamurras, në rrethin e Kurbinit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohet fondi prej 617 600 lekë për likuidimin e z. Gjet Lleshi nga të cilat 134 600 lekë për riparimin e dëmit në ndërtesë dhe 483 000 lekë për ndërtimin e masave mbrojtëse.

15. Ngarkohet Bashkia Mamurras për kontrollin e përdorimit të këtij fondi në destinacionin e përcaktuar në pikën 14 të këtij vendimi.

16. Ngarkohet Prefektura Lezhë për kontrollin e zbatimit të pikave 14, 15 të këtij vendimi.

17. Komunës Malzi në rrethin e Kukësit, në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohet një fond prej 424 105 lekë për likuidimin e Z. Ramadan Dema nga të cilat 355 105 lekë për blerjen e banesës së re dhe 69 000 lekë për blerjen e pajisjeve e orendive.

18. Ngarkohet Komuna Malzi të ndjekë zbatimin e këtij vendimi dhe kontrollin e përdorimit të këtij fondi në destinacionin e përcaktuar.

19. Ngarkohet Prefektura Kukës për kontrollin e zbatimit të pikave 17, 18 të këtij vendimi.

20. Bashkisë Vlorë në buxhetin e miratuar për vitin 1998, i shtohet fondi prej 1 004 000 lekësh për dhënie ndihme për rast fatkeqësie për z. Ethem Hasan Shaqiri nga të cilat 924 000 lekë për blerjen e ndërtesës së re dhe 80 000 lekë për blerjen e orendive e pajisjeve.

21. Ngarkohet Bashkia Vlorë për zbatimin e pikës 20 të këtij vendimi.

22. Ngarkohet Prefektura Vlorë për ndjekjen e zbatimit të pikës 20 e 21 të këtij vendimi.

23. Efektet financiare për përballimin e fatkeqësive të lartpërmendura në masën prej 6 895 936 lekë të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko